

Nr. Prot. Tiranë ___/___/2023

Nr. Dok. 202300449/2

Lënda: *Rekomandohet përmirësimi i domosdoshëm i kushteve për trajtimin e pacientëve në Spitalin Psikiatrik "Sadik Dinçi", Elbasan.*

Drejtuar: Drejtorisë së Përgjithshme të Operatorit të Shërbimeve të
Kujdesit Shëndetësor

TIRANË

Spitali Psikiatri "Sadik Dinçi"

ELBASAN

Për dijëni : Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

TIRANË

Të nderuar,

Avokati i Popullit, vlerëson bashkëpunimin e deritanishëm dhe angazhimin dhe punën e të gjithë stafit të institucionit që ju drejtoni, si dhe frymën e mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis institucioneve tona. Në vijim po ju njohim mbi inspektimin që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në institucionin tuaj në datë 17.05.2023.

Inspektimi u krye nga Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim Mekanizmi Kombëtar, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, dhe nenit 31 të ligjit nr. 44/2012 "Për Shëndetin Mendor", i ndryshuar, sipas Planit të Inspektimit për vitin 2023 të miratuar nga Avokati i Popullit.

Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Lindita Dedegjoni, znj. Nertila Qafzezi dhe z. Hazbi Selita, me detyrë ndihmës komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar të institucionit të Avokatit të Popullit.

Pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, Institucioni i Avokatit të Popullit ka detyrimin ligjor t'ju parashtojë gjetjet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

Shënime paraprake

Kjo ishte vizita periodike monitoruese e MKPT-së në Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinçi” në Elbasan, për vitin 2023. Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi monitorues fillimisht u takua me drejtorin e këtij institucioni z. Klajd Gripshi, për ta informuar mbi qëllimin e monitorimit dhe për të mbledhur informacionet e nevojshme zyrtare.

Më tej, grupi i inspektimit vizitoi ambientet e këtij shërbimi. Nga inspektimi në vend, kontakti me stafin dhe pacientët, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, objekteve, pajisjeve dhe mjediseve, grupi inspektues grumbulloi informacion në lidhje me të drejtat, kushtet dhe trajtimin e pacientëve, respektimin e të drejtave të tyre, si dhe me problematikat e ndeshura gjatë punës.

Nga informacioni, rezultoi se kishin gjetur zbatim vetëm një pjesë e rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm:

- Ishin marrë masa për riorganizimin e pavijoneve të pacientëve akut më vite.
- Ishin marrë masa për vendosjen e kartës të së drejtave të pacientëve në të gjitha pavijonet, korridoret dhe ambientet e përbashkëta të spitalit.
- Ishin marrë masa për zëvendësimin e regjistrave, të cilët ishin të sekretuar, si dhe trajnimin e stafit për plotësimin e saktë të tyre.

Ndërkohë një pjesë e rekomandimeve të paraqitura nga Avokati i Popullit nuk kishin gjetur zbatim dhe nuk ishin plotësuar. Më konkretisht:

- Nuk ishin marrë masa për realizimin e rikonstruksionit të plotë të godinës së Spitalit Psikiatrik “Sadik Dinçi” në Elbasan, sipas parashikimeve të bëra ndër vite për këtë institucion.
- Nuk ishin marrë masa për zgjidhjen e problemit të trajtimit si rezidentë të personave me aftësi të kufizuara intelektuale në kundërshtim me legjisllacionin në fuqi.
- Nuk ishin marrë masa që dhoma e kufizimit fizik të ndërtohet dhe pajiset në përputhje me “Standardet e Kufizimit Fizik në Shërbimet e Shëndetit Mendor të Specializuar me Shtretër”, në zbatim të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor” të ndryshuar, përkatësisht Kreu V “Trajtimi në Shërbimet e Shëndetit Mendor të Specializuar me Shtretër”, neni 27 “Kufizimi Fizik”.

- Nuk ishin marrë masa për vendosjen e një sistemi monitorues kamerash vëzhgimi në të gjitha ambientet e këtij institucioni, si një ndër aspektet më të rëndësishme të parandalimit të veprave të dhunshme ndaj shtetasve dhe anasjelltas, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.
- Nuk ishin marrë masa për shtimin në organikën e këtij institucioni të numrit të mjekëve psikiatër, infermierëve, kujdestarëve, berberit dhe një punonjësi për mirëmbajtjen, në përputhje me nevojat për trajtim të pacientëve në shërbim të shëndetit mendor me shtretër.
- Nuk ishin marrë masa për përmirësimin e kushteve në pavijone, dushe dhe tualete në mënyrë që të ofrohet një shërbim sa më dinjitoz për personat që trajtohen në këtë spital.
- Nuk ishin marrë masa për shtimin e kapaciteteve të shtëpizave me qëllim shtimin e aktiviteteve sociale.
- Nuk ishin marrë masa për vënien në funksion të Laboratorit klinik bio-kimik.

Drejtori i Spitalit Psikiatrik “Sadik Dinçi” në Elbasan, na informoi se të gjitha problematikat janë adresuar institucioneve përgjegjëse me një komunikim të vazhdueshëm, por ende nuk kanë marrë një zgjidhje. Ndërkohë evidentojmë nivel të ulët të kujdesit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit.

Struktura dhe organika e institucionit ishte e përbërë nga 193 punonjës, prej të cilëve: 136 punonjës në përbërje të ekipit multidisiplinar, përkatësisht 7 mjekë psikiatër, 7 psikologë, 4 punonjës social, 68 infermierë, 43 kujdestarë, 2 farmacistë, 1 stomatolog, 4-terapist okupacional dhe 57 punonjës pastrami dhe staf mbështetës.

Spitali Psikiatrik “Sadik Dinçi” në Elbasan përbëhej nga 8 pavijone me kapacitet zyrtar prej 310 pacientësh dhe dy shtëpiza, strehimi i mbështetur “Drita” në Elbasan dhe shtëpiza e mbrojtur “Jeta” në Cërrik. Më konkretisht, Pavijoni i Pranim-Urgjencës, 2 Pavijone Akut, 2 Sub-Akut dhe 2 Kronik (Gra-Burra).

Pacientët ishin të ndarë në pavijone, akut, subakut dhe kronik si më poshtë:

- Klinika e pranimit: pacientë akut, 8 burra
- Klinika I: pacientë kronik, 60 burra
- Klinika II: pacientë kronik, 63 burra
- Klinika III: pacientë kronik, 43 gra
- Klinika IV: pacientë subakut, 39 gra
- Klinika V: pacientë akut, 27 burra
- Klinika VI: pacientë akut, 19 burra

➤ **Klinika VII: pacientë subakut 48 burra**

Puna e shërbimit psikosocial ndahej sipas pavijoneve. Psikologu kryente vlerësimin e funksionimit psikologjik dhe mendor, si pjesë e vlerësimit multidisiplinar, që i bëhet pacientit pas kontaktit të parë në shërbim. Vlerësimi mund të bëhej në bazë të intervistës së strukturuar klinike ose duke përdorur teste të standardizuara të aftësive mendore dhe ose psikologjike. Stafi psiko-social pasi bënte një vlerësim psikologjik fillestar të cilin e pasqyronte në kartelën mjekësore të pacientit, bënte edhe ndjekjen e ecurisë së tij paralelisht me trajtimin terapeutik okupacional. Përgjatë inspektimit konstatoam se mundësitë terapeutike për këta persona ishin si në sallat në ambientet e brendshme të spitalit ashtu dhe dy shtëpizat, strehimi i mbështetur “Drita” në Elbasan dhe shtëpiza e mbrojtur “Jeta” në Cërrik në të cilën zhvilloheshin aktivitete të ndryshme riaftësuese, individuale dhe në grup.

Nga ana e stafit psiko-social, pacientët trajtoheshin me seanca këshillimore individuale apo në grup, psiko-edukim dhe mbështetje emocionale. Punonjësi social ofronte menaxhimin e rastit që përfshinte krijimin dhe nxitjen e bashkëpunimit midis profesionisteve të ekipit multidisiplinar të një shërbimi dhe midis shërbimeve të ndryshme në funksion të përmirësimit të situatës psiko-sociale apo zgjidhjes së problematikave të një pacienti ose grupi pacientësh.

Ambientet e jashtme, për zhvillimin e aktiviteteve apo terapive në grup nga ana e stafit psiko-social, ishin të bollshme, të rregullta dhe të organizuara mirë përreth dy qendrave ditore “Tulipan” dhe “Jeta”. Aty zhvilloheshin aktivitete të ndryshme si vizatime, piktura dhe argetime me muzikë. Në ditën e inspektimit shumë pacientë u takuam nga ana jonë dhe në ambientet e jashtme. te godinës,

Takimet me familjarët kryheshin në ambientet të brendshme të spitalit në çdo kohë dhe pa limit.

Konteksti dhe kuadri ligjor e institucional

Shërbimi shëndetësor në Shqipëri është rregulluar me ligjin nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili përcakton parimet kryesore dhe kuadrin ligjor për rregullimin, organizimin dhe funksionimin e sistemit të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë. Ndërkohë që shërbimi i shëndetit mendor në Shqipëri është rregulluar me ligj të posaçëm që në vitin 1996, përkatësisht me ligjin nr. 8092, datë 21.03.1996, “Për shëndetin mendor”, i cili më pas u shfuqizua me ligjin nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”, i ndryshuar, që synonte përmirësimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e kësaj kategorie. Ky ligj solli nevojën e reformave në lidhje me ngritjen dhe zhvillimin në shkallë kombëtare të kujdesit komunitar të shëndetit mendor si e vetmja mënyrë për të arritur shërbime komunitare të shëndetit mendor për të gjithë (përfshi deinstitutionalizimin të personave që vuajnë sëmundje të shëndetit mendor, monitorimin e të drejtave dhe lirive themelore nga mekanizma të jashtëm, pjesëmarrjen aktive të aktorëve të shoqërisë civile, etj).

Në konceptin gjithëpërfshirës, kuadri ligjor dhe institucional ofron mundësinë e një sistemi të integruar të shërbimeve të shëndetit mendor, i cili nënkupton një rrjet shërbimesh në nivel rajonal.

Gjetjet e evidentuara përgjatë inspektimit

Në ditën e inspektimit në këtë shërbim me shtretër me kapacitet zyrtar prej 310 personash, binte në sy gjëndja e rënduar e kushteve të godinës dhe mosrespektimi i hapësirave jetike, kusht ky i domosdoshëm për trajtimin njerëzor të pacientëve në institucione psikiatrike.

Në momentin e vizitës monitoruese trajtoheshin 308 pacientë të shtruar, nga të cilët 106 gra dhe 202 burra. Megjithëse në dukje nuk jemi në kushtet e mbipopullimit, akomodimi dhe qëndrimi i 10 pacientëve në një dhomë i bën kushtet të papërshtatshme dhe shume të vështira për këtë kategori pacientësh.

Dy pacientë ndodheshin me masë mjekësore të vendosur nga gjykata (1 grua dhe 1 burrë). Në kundërshtim me nenin 28 të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, të ndryshuar vazhdonin të sillleshin në këtë institucion në bazë të vendimeve gjyqësore, persona me çrregullime të shëndetit mendor që kanë kryer vepra penale për të cilat gjykatat kanë marrë vendim “mjekim të detyruar në një institucion mjekësor”. Theksojmë se Spitali Psikiatrik “Sadik Dinçi” në Elbasan, nuk është një institucion i posaçëm mjekësor për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor që kanë kryer vepra penale për të cilat gjykatat kanë marrë vendim për “mjekim të detyruar në një institucion mjekësor”.

Grupi inspektues bëri takime private, pa praninë e personelit të shërbimit me **personat me masë mjekësore “mjekim i detyruar”**. Ata për momentin ishin nën kujdesin intensiv të stafit mjekësor, nga biseda private me të sëmurët ata shprehën pozitivitet dhe nuk kishin ankesa për keqtrajtim fizik apo ushtrim dhune nga personeli i këtij shërbimi.

Gjatë inspektimit u evidentuan edhe njëherë **mungesa në investime dhe mirëmbajtje të institucionit**, për rrjedhojë kushtet vazhdojnë të jenë të rënduara dhe si pasojë e amortizimit. Vazhdonte problemi i lagështirës së theksuar dhe të gjitha ambientët e spitalit ishin të palyera. Sa më sipër u informuam nga Drejtori i Spitalit, në lidhje me planifikimin e rikonstruksionit të plotë të godinës së Spitalit Psikiatrik Elbasan, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është bërë me dije se rikonstruksioni do të fillojë në vitin 2024.

Megjithë nevojën për investime, kushte me të mira materiale për një shërbim cilësor, për shkak të kategorisë së personave që trajtohen aty, si dhe pas rekomandimeve të Avokatit të Popullit për ndërhyrje urgjente për shkak të kushteve tepër të vështira në këtë spital, vazhdon të jetë situata e njëjtë dhe pa mbështetje nga strukturat shtetërore.

Tualetet dhe dushet ishin tërësisht të amortizuar dhe me lagështirë.

Duhet të theksojmë se kushtet infrastrukturore luajnë rol të rëndësishëm për mirëqenien e të sëmurëve me çrregullime të shëndetit mendor. Akomodimi i këtyre personave në këtë institucion është më i përshtatshëm se akomodimi jo adekuat i personave me masë mjekësore “mjekim i detyruar” dhe “shtrim i përkohshëm” të vendosur nga gjykata, në IEVP Lezhë, por përsëri ka nevojë urgjente që Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marrë masa afatgjata për trajtimin dhe zgjidhjen e kësaj çështje.

Gjatë inspektimeve të zhvilluara nga MKPT në vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022 janë evidentuar nevojat për investime, kushte me të mira materiale për një shërbim cilësor, nevojë për një numër në rritje të stafeve mjekësore dhe mbështetëse. Në përgjigje të raporteve me rekomandime të MKPT-së gjatë viteve 2020, 2021 dhe 2022 jemi bërë me dije se, është planifikuar rikonstruksioni i plotë i godinës së Spitalit Psikiatrik "Sadik Dinçi" Elbasan, duke marrë parasysh edhe rekomandimet e institucionit të Avokatit të Popullit lidhur me kushtet infrastrukturore dhe të organizimit të këtij shërbimi. Por, nga monitorimi i buxhetit të këtij institucioni edhe për vitin 2023, ky fond nuk është lëvruar ende dhe sipas informacionit, investimi për rikonstruksionin e spitalit nuk është kryer.

Komiteti për Parandalimin e Torturës në Këshillin e Evropës (KPT) gjatë vizitës së tij në Shqipëri në vitin 2018, në raportin me rekomandime drejtuar Qeverisë Shqiptare¹, ka theksuar se: *“Për sa i përket kushteve të jetesës së pacientëve në Spitalin Psikiatrik të Elbasanit Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka planifikuar në vitet e ardhshme rindërtimin e Spitalit Psikiatrik të Elbasanit bazuar dhe në rekomandimet e Delegacionit për kushtet e jetesës të cilat do të zbatohen në projektin e rindërtimit”*.

Rekomandimi i KPT-së për këtë çështje, është i pazbatuar.

KPT ndër vite ka ngritur shqetësimin se pacientët me çrregullime të shëndetit mendor në Shqipëri vazhdojnë të mbahen në kushte të papranueshme. Në fakt, kushtet e jetesës në këtë institucion ishin përkeqësuar më tej dhe niveli i kujdesit psikiatrik mbetet qartë i pamjaftueshëm. Në përgjithësi, Komiteti krijoi përshtypjen e “braktisjes terapeutike” të shumë pacientëve.

Në vlerësimin e Avokatit të Popullit personat me çrregullime të shëndetit mendor e kanë domosdoshmëri trajtimin nga mjeku specialist psikiatër dhe nga ekipi multidisciplinar. Kësaj i shtohet edhe fakti që në vite nuk ka patur një përmirësim të qenësishëm në rritjen e numrit të stafit mjekësor, megjithë rekomandimet e Avokatit të Popullit, **si dhe situata e braktisjes terapeutike e konstatuar edhe përgjatë inspektimit, ende nuk ka ndryshuar.**

Një problematikë e pazgjidhur është edhe **mungesa e një laboratorit klinik-biokimik** dhe për rrjedhojë, realizimi i kryerjes së analizave për pacientet e këtij shërbimi, vazhdon të bëhet në Spitalin Rajonal Elbasan.

Ndërkohë **furnizimi me komplete të përshtatshme** fjetjeje dhe veshmbathje, ishte në sasi të mjaftueshme. Furnizimi me produkte higjieno-sanitare dhe pajisje të tjera individuale, ka pasur mungesa, pasi për dy vjet nuk bëhet tenderimi i përqëndruar, por nevojat e institucionit mbuloheshin me blerje të vogla.

Furnizimi me ujë të rrjedhshëm ishte siguarur ndërsa ngrohja bëhej me sistem qendror ngrohje, i cili siguronte ngrohje në periudhën e dimrit dhe ajër të kondicionuar gjatë verës.

Përsa i përket ushqimit, ai sigurohej nga kontraktimi i një shoqërie private e cila përfshinte përgatitjen dhe servirjen e ushqimit të pacientit, në bazë të sëmundshmërisë. Dieta, për pacientë me dietë speciale apo pacientët diabetik përcaktohej nga mjeku.. Kuzhina ishte e pastër. Sistemi i aspirimit ishte funksional. Kuzhinierët dhe punonjësit që shpërndanin ushqimin, ishin të pajisur me librezën shëndetësore të higjienës. Kampionet ushqimore ruheshin rregullisht në kushte frigoriferike.

Furnizimi me medikamente u referua se nuk kishte probleme për këtë institucion, pasi sigurohej sipas nevojave dhe kërkesave me tenderim nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Spitali nuk kishte ambulancë, pasi ajo që ka qenë, është jashtë funksionit që nga muaji gusht 2018.

Shtrime të pavullnetshme nuk kishte për vitin 2023, deri në ditën e inspektimit. Në institucion mbahej “Regjistri i trajtimit të pavullnetshëm”.

¹ CPT Report 2019, <https://rm.coe.int/16809cb571>

Shërbimi dentar kishte probleme pasi aparatura është e amortizuar dhe nuk funksionon me standard.

Sistemi i ankimit ishte në funksion edhe në rastin e kërkesave/ankesave nga grupe interesi si p.sh., shoqata apo grupime të tjera vullnetare të pacientëve, familjarë ose persona të interesuar për mbrojtjen e interesave të personave me çrregullime të shëndetit mendor. Pasi njiheshin me kërkesë/ankesën personi i ngarkuar i spitalit mblidhte të gjithë informacionin e nevojshëm (kartela, shtrime, observacione), dhe më pas gjykonte nga ana mjekësore duke u konsultuar me stafin mjekësor kthente përgjigjen që në shumicën e rasteve nënkuptonte zgjidhjen e këtij pretendimi. Drejtuesit e institucionit na informuan se ata i ndiqnin dhe më tej rastet e kërkesë/ankesave pas kthimit të përgjigjes në rrugë zyrtare

Ligji për shëndetin mendor, në nenin 31 të tij, përcakton procedurat e monitorimit të jashtëm të shërbimit të shëndetit mendor nga Avokati i Popullit, nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimin Çnjerëzor dhe Poshtëruës, që vepron si strukturë e veçantë nën autoritetin e tij. Ligji garanton vëzhgimin e rregullt me anë të inspektimeve periodike, për të respektuar të drejtat dhe standardet që u ofrohen personave me çrregullime të shëndetit mendor në mjediset e shërbimit të shëndetit mendor të specializuar me shtretër, si dhe paraqet rekomandime në organet përkatëse, me qëllim përmirësimin e trajtimit dhe kushteve të pacientëve dhe sigurimin e respektimit të plotë të të drejtave të njeriut në institucionet e kujdesit të shëndetit mendor.

Me keqardhje vërejmë një kujdes minimal nga institucionet shtetërore për garantimin e kushteve normale për këta të sëmurë që janë kategori shumë vulnerabel si psh, akomodimi i 10 apo 12 pacientëve në një dhomë, duke mos pasur hapësirat e nevojshme si dhe kushtet shumë të amortizuara të pajisjeve dhe të gjithë ambienteve ku qëndrojnë këta të sëmurë. Diktuar nga një numër në rritje i sëmundjeve/çrregullimeve mendore, i tipologjive, i grup moshave, i shtrirjes gjeografike, çrregullimeve për shkak të përdorimit të substancave narkotike, etj., lind domosdoshmëri ndryshimi dhe përmirësimi i mbrojtjes dhe kujdesit të pacientëve në kushte të tilla komplekse/ të vështira. Praktika botërore vë theksin në politika lehtësuese dhe mbështetëse për shërbimet e shëndetit mendor, duke vendosur prioritete strategjike që lidhen me trajtimin, ndjekjen, trajtimin spitalor të këtyre pacientëve (shërbimet e shëndetit mendor) në krahasim me shërbimet e kujdesit shëndetësor në tërësi. Për këtë ndërhyrje të rëndësishme, strukturat qeverisëse duhet të krijojnë hapësira për zgjerimin e mbështetjes dhe garantimit të prioriteteve ndaj këtij shërbimi mjekësor për të garantuar mirëfunksionimin e çdo strukture apo specialiteti.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave për realizimin e rikonstruksionit të plotë të godinës së Spitalit Psikiatrik “Sadik Dinçi”, në Elbasan, sipas parashikimeve të bëra ndër vite për këtë institucion.

2. Marrjen e masave për sigurimin e një dhome izolimi në Shërbimin e Shëndetit Mendor me shtretër Elbasan në përputhje me nenin 27 të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”.
3. Marrjen e masave për zgjidhjen e problemit të trajtimit si rezidentë të personave me aftësi të kufizuara intelektuale në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.
4. Marrjen e masave që dhoma e kufizimit fizik të ndërtohet dhe pajiset në përputhje me “Standardet e Kufizimit Fizik në Shërbimet e Shëndetit Mendor të Specializuar me Shtretër”, në zbatim të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor” të ndryshuar, përkatësisht Kreu V “Trajtimi në Shërbimet e Shëndetit Mendor të Specializuar me Shtretër”, neni 27 “Kufizimi Fizik”.
5. Marrjen e masave të menjëhershme për vendosjen e një sistemi monitorues kamerash vëzhgimi në të gjitha ambientet e këtij institucioni, si një ndër aspektet më të rëndësishme të parandalimit të veprave të dhunshme ndaj shtetasve dhe anasjelltas, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.
6. Marrjen e masave për përmirësimin e kushteve në pavijone, dushe dhe tualete në mënyrë që të ofrohet një shërbim sa më dinjitoz për personat që trajtohen në këtë spital.
7. Marrjen e masave për shtimin në organikën e këtij institucioni të numrit të mjekëve psikiatër, infermierëve, kujdestarëve, punonjës pastrimi, berber dhe një punonjësi për mirëmbajtjen, në përputhje me nevojat për trajtim të pacientëve në shërbim të shëndetit mendor me shtretër, sipas konstatimeve në vijimësi të Institucionit të Avokatit të Popullit.
8. Marrjen e masave për sigurimin e një Laboratori klinik bio-kimik.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

KOMISIONER

AHMET PRENÇI

Konc.:L Dedegjoni